

STATUTI

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“LOKA PJESE KEMBIMI ” Shpk.

Neni 1

Nga ortaku i vetem themelues është krijuar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “LOKA PJESE KEMBIMI ” shpk

Neni 2

Shoqëria është formuar sipas legjislacionit shqiptar dhe si person juridik fillon me regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 3

Shoqëria e ka selinë ne Sukth, Zona Kadastrale 3542 Nr Pasurise 31/71/ND, Durres
„Durres Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të Ortakut te Vetem.

Neni 4

Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me statutin e saj në teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij

Neni 5

Fusha e autoritetit te ortakut dhe norma e fitimeve apo humbjeve, kopetencat që gëzon në marrjen e vendimeve do të kenë si kriter bazë raportet e pjesmarrjes ne kapitalin e shoqerise.

Neni 6

Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marëdhëniet e punës, shoqëria do të ketë librin e vet i cili do të quhet libri i shoqërisë.



Neni 7

Ortaku si dhe personat e tjerë të pranuar në shoqëri bien dakort që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që disponon shoqëria, kontratat që do të lidhë si dhe planet ose qëllimet që ka për të ardhmen.

Neni 8

Të gjitha aktet dhe dokumentat që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët duhet të tregojnë lexueshëm emrin e shoqërisë. Niptin e shoqërisë dhe adresën e shoqërisë

Neni 9

Shoqëria ka objekt veprimtarie Tregeti me shumice e pakice të pjesëve të kembimit dhe aksesor të tjere për automjete

Neni 10

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat , duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Qendren Kombetare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të afatit sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me Vendim të Ortakut.

Neni 11

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë: Shoqëria mund të shtojë kapitalin e saj sipas vendimit të ortakut të vetem.

Neni 12

Kapitali themeltar i shoqërisë prej 100 000 lekë është i ndare në 1 kuote me vlerë nominale 100.000 leke një kuote. Ky kapital është i formuar në masë 100 % nga kontributi i Ortakut të Vetem Hamit Loka



Neni 13

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek personat e tretë në qoftë se vendos për këtë ortaku. Gjithashtu ato janë lirisht të transferueshme në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve, si dhe në rrugë trashëgimie. Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me një akt noterial.

Neni 14

Shoqëria do ta konsideroj qendrën e vet si shoqëria nënë e cila rast pas rasti mund të hapet me anë filialesh, agjensish në të gjitha ato vende ku do të shikoj interes në përmbushjen e qëllimit të saj brenda dhe jashte teritorit të Shqipërisë .

Neni 15

Organet e shoqërisë janë si më poshtë:

- 1.Ortaku i Vetem.
- 2.Administratori

Neni 16

Administrator i shoqërisë është Hamit Loka .me nje kohezgjatje prej pese vjetesh,nga dita e krijimit i cili është përgjegjës për shkelje ligjore, për shkelje të statutit ose për gabime e faje të kryera gjatë administrimit.

Neni 17

Shoqëria është e detyruar të mbajë dokumentacionin kontabël, librin e shoqërisë në të cilin shënohen emri i plotë i shoqërisë, ortakun, kapitalin themeltar si dhe vendimet që merr ortaku i vetem.



Neni 18

Bilanci financiar mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetore, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet miratohen nga Ortaku i Vetem. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brënda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar. Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë për çdo arsye. Për këtë Ortaku i Vetem vendos për mënyrën e likuidimit të saj. Caktohen një ose disa likuiditorë. Radhe e pagesave është ajo e përcaktuar në ligjin e likuidimit të shoqërive dhe në ligjin për procedurë tatimore

Neni 19

Ortaku i Vetem nëpërmjet vendimeve që merr realizon të gjithë veprimtarinë e shoqërisë. Ai përcakton drejtimet kryesore, vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, në aktin e themelimit, për shtimin e kapitalit, për pranimin në shoqëri të ortakëve të tjerë, të gjitha këto në zbatim të ligjit për shoqëritë tregtare.

Shoqëria përgjigjet vetëm me pasurinë e saj. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet që ortaku merr përsipër si person fizik tej veprimtarisë së shoqërisë dhe nuk përballon personalisht humbjet e shoqërisë tej kontributit të kapitalit të vënë në shoqëri.

Neni 20

Administratori lidh kontrata me persona fizik e juridik shtetëror ose privat, vendas e të huaj sipas vendimeve që merr ortaku i vetem si dhe ndjek drejtimet e aktivitetit të shoqërisë. Administratori ka të drejtë të emërojë përfaqësues të posaçëm çdo person të tretë për të kryer veprime në emër të tij për llogari të shoqërisë. Ortaku i Vetem vendos për fuqinë punëtore, për pagat e tyre duke lidhur kontrata me ta sipas marrëveshjes së dyanshme, në përputhje me ligjet shqiptare.



Neni 21

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje “LOKA PJESE KEMBIMI
„SHPK, Durres. Mund te kete edhe te dhena te tjera me qellim reklamues dhe ,ose
,adresues

Neni 22

Përsa nuk është shkruar në këtë statut i referohet plotësimeve nga
vendimet e Ortaku i Vetem si dhe ligjit përkatës shqiptar për shoqëritë tregtare.

Neni 23

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së
shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit do të paraqiten për zgjidhje gjykatës
kompetente.

Neni 24

Ky statut është hartuar në 4 kopje për tu administruar sipas ligjit.

Ortaku i Vetem

(HAMIT LOKA)



DURRES,01 /10/ 2023